

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit S. M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.857/15 të datës 14.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Besim Susuri, dhe të akuzuarit, me date 27.07.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S. M., nga i ati H., e ëma A., e lindur J., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin K., Komuna e Prizrenit, tani jeton në Prizren, Rr. ... nr..., ka të kryer shkollën e lartë, tregtar, i martuar, baba i pesë fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 06.01.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në Rr. ..., nr..., në lokalit të tij, merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, duke anashkaluar njësinë elektrike, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëme material në vlerë të energjisë së shpenzuar në shumë prej gjithsejtë 118.54 Euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

II.Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 06.01.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në Rr. ..., nr..., në lokalit të tij, merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, duke anashkaluar njësinë elektrike, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëme material në vlerë të energjisë së shpenzuar në shumë prej gjithsejtë 65.70 Euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

III.Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 06.01.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në Rr. ..., nr..., në lokalit të tij, merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që

shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, duke anashkaluar njësorin elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me ç'rasht të dëmtuarës KEDS-Divizioni i rjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëme material në vlerë të energjisë së shpenzuar në shumë prej gjithsejtë 65.70 Euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg.

E dëmtuara: KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.857/15 të datës 14.10.2015, kundër të akuzuarit S. M., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Besim Susuri në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj pranë aktakuzës PP.nr.857/2015 të dt. 14.10.2015 kundër të akuzuarit S. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KPK-së, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat i ka kryere nga mosdija së lëshim i punëtorit që e ka bërë instalimin e energjisë elektrike i cili me rastin e testim të instalimit të bërë nuk e ka bërë shkyçjen e rjetit për atë pjesë të lokalit që nuk shfrytëzohen. Andaj përgjegjësi e këtu të akuzuarit qëndron vetëm në faktin që njëhisorët kanë qenë në emrin e

tij, fjala është për dy njehsorët, e po ashtu edhe tre dalje tjera që kanë qenë pa njehsor, e që në ndërkohë janë vendosur njehsorët nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, janë në shfrytëzim të energjisë elektrike në emër të akuzuarit.

I akuzuari S. M. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranojë veprën penale cila më vihet në barrë, tërë ngjarja e konstatuar nga ana e zyrtarëve të KEDS-it, në ditën me rastin e kontrollimit të shfrytëzimit të energjisë elektrike është përshkruar nga deklaratat e dëshmitarëve. Theksoj që në kryerjen e kësaj vepre nuk ka pasur as qëllim e as dashje nga ana ime, ka qenë vetëm një gabim i cili gabim po ashtu nuk ka qenë i imi, por pasi që energjia elektrike është në emrin tim në objektin e cekur, e pranoj veprën penale si në aktakuzë. Andaj, i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë dhe të cekurat më lartë si dhe faktin që jam person familjar, babai i pesë fëmijëve, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, premtimin tim që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjajshme, të gjitha këto rrethana konsideroj që janë rrethana të mjaftueshme që gjykata të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

I.Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 06.01.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në Rr. ..., nr..., në lokalit të tij, merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, duke anashkaluar njësorin elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëme material në vlerë të energjisë së shpenzuar në shumë prej gjithsejtë 118.54 Euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

II.Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 06.01.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në Rr. ..., nr..., në lokalit të tij, merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, duke anashkaluar njësorin elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëme material në vlerë të energjisë së shpenzuar në shumë prej gjithsejtë 65.70 Euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

III.Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 06.01.2015, në orë të pavërtetuar, në Prizren, në Rr. ..., nr..., në lokalit të tij, merr, përdor duke u furnizuar përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit shpërndarës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, duke anashkaluar njësorin elektrik, ashtu që bënë shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEDS- Divizioni i rrjetit – Distrikti në Prizren, i shkakton dëme material në vlerë të energjisë së shpenzuar në shumë prej gjithsejtë 65.70 Euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lidhja pa autorizuar në shërbime nga neni 321 të KP-ës, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i katër fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1748/15 me datë 27.07.2016

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.